


BULETINI 2025



KOMUNA E LIPJANIT



MAJ

Kryetari i Komunës së Lipjanit, z. Imri Ahmeti, ka nënshkruar marrëveshjen për vazhdimin e bashkëpunimit me organizatën The Foundation House, me qëllim mbështetjen dhe fuqizimin e të rinjve lipjanas.



Me këtë rast, Kryetari Ahmeti theksoi se kjo marrëveshje është dëshmi e përkushtimit të institucionit për t'u krijuar të rinjve hapësira të reja për zhvillim dhe për të investuar në të ardhmen e tyre, përmes aktiviteteve inovative, edukative dhe teknologjike. Kjo marrëveshje e re forcon partneritetin ndërmjet Komunës së Lipjanit dhe The Foundation House për realizimin e projekteve të përbashkëta që adresojnë nevojat dhe potencialin e të rinjve.

Fillon sesiioni informues për grantet në ndërmarrësi në Komunën e Lipjanit



Në sallën e Kuvendit Komunal të Lipjanit, është mbajtur sesiioni informues për mundësitë e përfitimit të granteve në fushën e ndërmarrësisë, një nismë që synon të mbështesë zhvillimin ekonomik dhe të fuqizojë iniciativat e reja të qytetarëve.

Në hapje të këtij sesiioni mori pjesë edhe kryetari i Komunës së Lipjanit, z. Imri Ahmeti, i cili theksoi rëndësinë e mbështetjes së ideve inovative dhe krijimit të kushteve më të favorshme për të rinjtë dhe gratë që synojnë të ndërtojnë biznese të qëndrueshme.

“Besoj fuqishëm se zhvillimi ekonomik fillon me përkrahjen e ideve të mira dhe me krijimin e kushteve që u mundësojnë atyre të realizohen. Si institucion, jemi të përkushtuar të ofrojmë mbështetje të vazhdueshme për qytetarët tanë, në bashkëpunim me partnerë si Islamic Relief Kosova, me qëllim të sjelljes së mundësive të reja dhe konkrete,” tha kryetari z. Imri Ahmeti.

Ai gjithashtu u bëri thirrje të gjithë të interesuarve që ta shfrytëzojnë këtë mundësi dhe të bëhen pjesë aktive e zhvillimit ekonomik të komunës sonë.

Në sesion morën pjesë edhe drejtoresha e organizatës Islamic Relief Kosova dhe drejtori për Ekonomi dhe Zhvillim i Komunës së Lipjanit, të cilët prezantuan detaje të rëndësishme rreth procesit të aplikimit dhe kriterëve për përfitim nga grantet.

Ky aktivitet përfaqëson një hap konkret drejt fuqizimit dhe nxitjes së zhvillimit ekonomik në nivel lokal.



Nënkryetari Bytyqi merr pjesë në ceremoninë e ndarjes së çmimit për esenë më të mirë dhe në aksionin për mbjelljen e drunjve në Gadime



Nënkryetari i Komunës së Lipjanit, z. Diamant Bytyqi, së bashku me Drejtorin e Arsimit, z. Rasim Hasani, kanë marrë pjesë në aktivitetin edukativ-mjedisor në ShFMU "Zenel Hajdini", të organizuar nga organizata AMJ-Kosova, ku u mbajtën garat për esenë më të mirë dhe u zhvillua një aksion për mbjelljen e rreth 30 drunjve dekorativë.

Me këtë rast, nënkryetari Bytyqi theksoi se garat në esë janë dëshmi e kreativitetit dhe mendimit të lirë të të rinjve tanë, ndërsa mbjellja e drunjve përfaqëson një investim simbolik për një të ardhme më të gjelbër dhe më të shëndetshme për të gjithë. Ky aktivitet kishte për qëllim të nxisë kreativitetin e nxënësve përmes të shkruarit, si dhe të rrisë vetëdijen mjedisore përmes përfshirjes së tyre në mbjelljen e drunjve.

Fillon zbatimi i projektit për rindërtimin e kadastrit, qytetarët informohen për të drejtat pronësore



Në Janjevë u mbajt takimi i parë publik me qytetarët, në kuadër të projektit për Rindërtimin e Kadastrit, një proces kyç për rregullimin e të drejtave pronësore dhe ndërtimin e një sistemi të qëndrueshëm të administrimit të tokës në Komunën e Lipjanit.

Në takim morën pjesë qytetarë të shumtë të Janjevës, të cilët u informuan nga përfaqësuesit institucionalë për rrjedhën dhe përfitimet e këtij procesi. Të pranishëm ishin edhe nënkryetari i Komunës së Lipjanit, z. Diamant Bytyqi, drejtoresha për Gjeodezi dhe Kadastër, znj. Safete Amerllahu, si dhe përfaqësues të Agjencisë Kadastrale të Kosovës.

Nënkryetari Bytyqi theksoi se rindërtimi i kadastrit nuk është thjesht një proces teknik apo administrativ, por një hap vendimtar drejt garantimit të së drejtës pronësore dhe sigurisë juridike për çdo qytetar.

Projekti i cili implementohet në bashkëpunim me Agjencinë Kadastrale të Kosovës dhe Komunën e Lipjanit, synon të sigurojë të dhëna të sakta pronësore dhe juridike, të cilat janë themel për zhvillim të qëndrueshëm.

Takime të tilla do të vazhdojnë edhe në lokalitete të tjera.

Në Komunën e Lipjanit, është zhvilluar një takim pune mes zyrtarëve komunalë dhe përfaqësuesve të Departamentit për Integritet Evropian të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL)



Qëllimi i këtij takimi ishte shkëmbimi i informatave, diskutimi i sfidave dhe identifikimi i veprimeve të përbashkëta për avancimin e procesit të integritetit evropian në nivel lokal.

Gjatë takimit, përfaqësues nga Komuna e Lipjanit theksuan përkushtimin institucional për zbatimin e standardeve dhe praktikave që kërkohen nga procesi i integritetit në Bashkimin Evropian.

Ndërsa zyrtarët nga MAPL-ja shprehën vlerësimin për angazhimin e Komunës së Lipjanit dhe ritheksuan rëndësinë e përforsimit të bashkëpunimit ndërinstitucional, si një mekanizëm kyç për përparimin e agjendës evropiane në nivel lokal.

Në kuadër të procesit të rindërtimit të kadastrit , një prej projekteve kyçe për rregullimin e të drejtave pronësore, po vazhdojnë takimet informuese me qytetarët e fshatrave Ribar i Madh dhe Kraishtë.



Qytetarë të shumtë morën pjesë në këto takime, ku u informuan nga afër për ecurinë e procesit, rëndësinë e përditësimit të të dhënave kadastrale , si dhe për mundësitë që u ofrohen për të verifikuar dhe rregulluar të dhënat e tyre pronësore .

Ky projekt synon krijimin e një regjistri të saktë dhe të besueshëm të pronësisë, i cili do të kontribuojë në rritjen e sigurisë juridike për qytetarët dhe në përmirësimin e shërbimeve publike në fushën e administrimit të tokës.

Nënkryetari Bytyqi nderon me homazhe martirët e fshatit Mirenë



Nënkryetari i Komunës së Lipjanit, z. Diamant Bytyqi, së bashku me bashkëpunëtorët e tij, ka bërë homazhe dhe ka vendosur buqetë me lule pranë pllakave përkujtimore të martirëve të fshatit Mirenë, në shenjë respekti për sakrificën e tyre për lirinë e atdheut.

Me këtë rast, nënkryetari Bytyqi theksoi se kujtimi për martirët dhe dëshmorët është i shenjtë dhe do të mbetet përherë i gjallë në kujtesën tonë kolektive. Është obligim i yni si institucion, por edhe si qytetarë, që ta ruajmë dhe ta përcjellim brez pas brezi këtë trashëgimi të lavdishme të qëndresës dhe flijimit për atdhe. Lavdi e përgjeshme martirëve dhe dëshmorëve të kombit!

Takim informues me qytetarët e Gadimes së Epërme për procesin e Rindërtimit të Kadastrit



Komuna e Lipjanit, në kuadër të projektit për rindërtimin e kadastrit, ka mbajtur takim informues me qytetarët e Gadimes së Epërme, ku u njoftuan në detaje për hapat që do të ndiqen gjatë procesit të matjes në terren, përpilimit të të dhënave kadastrale, si dhe ndërtimit të një regjistri kadastral të përditësuar.

Gjatë këtij takimi, Kryetari i Komunës së Lipjanit, z. Imri Ahmeti, theksoi rëndësinë e këtij procesi për qytetarët dhe i inkurajoi ata të jenë pjesë aktive në këtë fazë të rëndësishme të përmirësimit të regjistrimeve pronësore.

"Ky është një proces jashtëzakonisht i rëndësishëm, pasi u mundëson qytetarëve të zgjidhin problemet e hapura me pronat dhe të pajisen me dokumentacion të saktë dhe të ligjshëm. Rindërtimi i kadastrit është një hap thelbësor për ndërtimin e së ardhmes, me pronësi të qartë të sigurt dhe të mbrojtur juridikisht", tha Kryetari Ahmeti.

Komuna e Lipjanit u bën thirrje të gjithë banorëve të Gadimes së Epërme të përfshihen aktivisht në këtë proces dhe të shfrytëzojnë këtë mundësi për të rregulluar dokumentacionin e pronave të tyre në mënyrë të lehtësuar dhe ligjërish të sigurt.

Inaugurohet shkolla e re në fshatin Ribar i Madh



Inaugurohet objekti i ri i shkollës fillore në fshatin Ribar i Madh, një investim i financuar nga buxheti komunal, i cili ofron një hapësirë moderne, funksionale dhe të ngrohtë për nxënësit e këtij fshati. Kryetari i Komunës së Lipjanit, z. Imri Ahmeti, gjatë ceremonisë së përzurimit theksoi rëndësinë e këtij investimi për nxënësit, personelin arsimor dhe të ardhmen e gjeneratave të reja. “Shkollat ndërtohen rrallë dhe për periudha afatgjata, por dija ndërtohet çdo ditë në bankat e shkollës. Pamja e këtij fshati ka ndryshuar dhe me të ka ndryshuar edhe ndjenja e krenarisë së banorëve. Prindërit dhe qytetarët e Ribarit të Madh kanë sytë nga kjo shkollë, duke pritur që prej saj të dalin sa më shumë kuadro të përgatitura për të ardhmen,” tha kryetari z. Imri Ahmeti. Ai gjithashtu shprehu falënderim për drejtorin e shkollës, personelin arsimor, nxënësit dhe të gjithë qytetarët e fshatit, duke theksuar se ky investim përbën një kontribut të drejtpërdrejtë për të ardhmen e fëmijëve të kësaj zone.

Në përmbyllje, kryetari Ahmeti uroi nxënësit për ambientet e reja dhe i inkurajoi që të mësojnë, të ëndërrojnë dhe të rriten me dashuri në këtë hapësirë të re arsimore.

Urime të gjithë nxënësve dhe stafit të shkollës për fillimin në këto ambiente të reja dhe moderne!



Kryetari Ahmeti mori pjesë në marshimin tradicional në nderim të dëshmorëve të fshatit Krojmir



Kryetari i Komunës së Lipjanit, z. Imri Ahmeti, së bashku me bashkëpunëtorët e tij, mori pjesë në marshimin tradicional në fshatin Krojmir, i cili organizohet në nderim të Katër Heronjëve dhe Dy Martirëve të këtij fshati që ranë për lirinë e atdheut.

Me këtë rast, kryetari Ahmeti theksoi se ky aktivitet është një shprehje respekti dhe një kujtesë për obligimin tonë të përhershëm, moral e institucional, ndaj dëshmorëve të kombit.

Në kuadër të këtij aktiviteti, kryetari Ahmeti vendosi një buqetë me lule pranë pllakës përkujtimore të rënies së dëshmorit Halil Meta në Blinajë, një simbol i përjetshëm i sakrificës për liri.

“Por përtej ceremonive, nderimi më i madh që mund t’u bëjmë atyre është të punojmë me përkushtim për të ndërtuar një të ardhme më të mirë. Të forcojmë shtetin, të zhvillojmë vendin dhe të krijojmë kushte më të mira për brezat që vijnë kjo është rruga e vërtetë e nderimit të sakrificës së tyre”, tha kryetari z. Imri Ahmeti.

Ai gjithashtu falënderoi z. Hazir Murati, kryetar i Këshillit Organizativ, dhe z. Sami Qeriqi, kryetar i OVL-së së UÇK-së nëndega Krojmir, si dhe gjithë qytetarët e Krojmit për përkushtimin dhe angazhimin e treguar. Lavdi e përjetshme për Katër Heronjtë dhe Dy Martirët e Krojmit!

Komiteti për Komunitete ka zhvilluar punimet e mbledhjes së 38-të me radhë



Në sallën e takimeve të Komunës së Lipjanit, u mbajt mbledhja e 38-të e Komitetit për Komunitete (KK), e udhëhequr nga kryesuesi, z. Skender Bikliqi, ku u shqyrtuan të gjitha pikat e rendit të ditës.

Gjatë këtij takimi, përfaqësuesit nga Qendra për Punë Sociale, kanë prezantuar një informatë pune lidhur me numrin e rasteve sociale nga komuniteti jo shumicë në Komunën e Lipjanit

Në përfundim të mbledhjes, anëtarët e Komitetit shqyrtuan disa çështje dhe kërkesa të ndryshme që kanë pranuar nga komunitetet.

Nënkryetari Bytyqi nderon me homazhe katër dëshmorët e fshatit Krojmir në përvjetorin e rënies



Nënkryetari i Komunës së Lipjanit, z. Diamant Bytyqi, së bashku me bashkëpunëtorët e tij, ka bërë homazhe dhe ka vendosur buqetë me lule pranë pllakës përkujtimore të katër dëshmorëve të fshatit Krojmir, si dhe te varri i dëshmorit Halil Meta, në përvjetorin e rënies së tij.

Me këtë rast, nënkryetari Bytyqi theksoi se nderimi i dëshmorëve është një detyrë e përhershme, si për shoqërinë, ashtu edhe për institucionet. Sakrifica e tyre qëndron në themel të lirisë dhe shtetndërtimit tonë, ndërsa kujtimi për ta duhet të mbetet gjithmonë i gjallë, si frymëzim për brezat që vijnë.

Po ashtu sot shënohet edhe dita e shkollës së fshatit, e cila me krenari mban emrin e “Katër Dëshmorëve”, duke ruajtur kujtimin dhe amanetin e tyre për brezat e rinj.

Lavdi të gjithë dëshmorëve të kombit!

Është mbajtur takimi i aksionarëve të K.R.M. “Pastrimi” në Prishtinë, ku morën pjesë edhe përfaqësuesit e Komunës së Lipjanit, përfshirë kryesuesin e aksionarëve, z. Valon Pacolli, si dhe dy aksionarët e tjerë, z. Fadil Sopa dhe z. Ardit Cani.



Me këtë rast, kryesuesi, z. Valon Pacolli, në emër të aksionarëve nga Komuna e Lipjanit, shprehu shqetësimin lidhur me gjendjen e krijuar në kompani dhe informoi menaxhmentin dhe aksionarët e tjerë të pranishëm në takim për situatën e rënduar, e cila ka rezultuar në pamundësinë e grumbullimit të mbeturinave në disa fshatra të Komunës së Lipjanit gjatë javës së kaluar.

Në këtë takim u bë thirrje e qartë për të vazhduar me kërkesën vendimtare për decentralizim të plotë financiar të njësisë operative në Lipjan, me qëllim që problemet eventuale financiare ndërmjet kompanisë dhe komunave të tjera aksionare të mos ndikojnë në funksionimin normal të njësisë operative të Lipjanit.

Gjithashtu, u kërkua një zgjidhje e menjëhershme për situatën e krijuar dhe u theksua domosdoshmëria e garantimit të vazhdimësisë së shërbimeve për qytetarët e Komunës së Lipjanit.

Nënkryetari Bytyqi dhe Drejtoresha Reçica takojnë znj. Kristie Evenson nga OSBE



Nënkryetari i Komunës, z. Bytyqi, së bashku me Drejtoreshën për Kulturë, Rini dhe Sport, znj. Anila Reçica, kanë zhvilluar një takim me znj. Kristie Evenson, eksperte e OSBE-së për Programin e Rinisë.

Gjatë takimit, u diskutua Strategjia për zhvillimin dhe fuqizimin e rinisë në Komunën e Lipjanit dhe Plani i Veprimit për Rinor, i cili pritet të miratohet në seancën e ardhshme të Kuvendit Komunal. Ky plan përfshin objektiva të qarta dhe aktivitete të shumta që synojnë fuqizimin e të rinjve në komunën tonë. Nënkyetari Bytyqi shprehu mirënjohjen për znj. Evenson dhe OSBE-në për mbështetjen e tyre gjatë procesit të konsultimeve publike, duke theksuar rëndësinë e bashkëpunimit në hartimin e politikave rinore gjithëpërfshirëse. Komuna mbetet e përkushtuar në zbatimin e këtij plani, duke bashkëpunuar ngushtë me partnerët ndërkombëtarë dhe shoqërinë civile për të krijuar më shumë mundësi për të rinjtë dhe përfshirjen e tyre aktive në zhvillimin e komunitetit.

Komuna e Lipjanit prezanton Master Planin për Zhvillimin e Zonës së Goleshit në Konferencën e Investitorëve



Kryetari i Komunës së Lipjanit, z. Imri Ahmeti, së bashku me bashkëpunëtorët e tij, mori pjesë në Konferencën e Investitorëve për mundësitë e zhvillimit të turizmit lokal.

Gjatë kësaj konference, Kryetari Ahmeti theksoi se Master Plani për Zhvillimin e Zonës së Goleshit është një projekt strategjik dhe ambicioz, që synon transformimin e kësaj zone në një destinacion të qëndrueshëm turistik.

“Lipjani posedon resurse natyrore të pasura dhe atraktive, të cilat përbëjnë një bazë të fortë për zhvillimin e turizmit lokal. Kodra e Goleshit, një nga asetet tona më të çmuara natyrore, tashmë ka një master plan të gatshëm, i cili përfshin të gjithë komponentët e nevojshëm për ta shndërruar atë në një zonë funksionale për turizëm gjithëvjeter”, ka thënë Kryetari, z. Imri Ahmeti.

Gjatë konferencës u prezantuan edhe mundësitë konkrete për investime në përputhje me master planin, si dhe modelet për zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm dhe promovimin e aktiviteteve në natyrë si paragliding, ecje malore dhe çiklizëm.

“Synimi ynë është të krijojmë një infrastrukturë të përshtatshme, që siguron akses më të lehtë, nxit interesin e investitorëve dhe sjell zhvillim ekonomik lokal përmes turizmit”, ka shtuar Kryetari Ahmeti.

Ky plan zhvillimor përbën një hap të rëndësishëm drejt shfrytëzimit të resurseve natyrore të komunës dhe krijimit të kushteve për një perspektivë të re ekonomike përmes turizmit.





Fotolajm: Nënkryetari i Komunës së Lipjanit ka nënshkruar Memorandum Mirëkuptimi me përfaqësuesit e organizatës humanitare “Humanity First”, për shpërndarjen e pakove ushqimore me produkte mishi për 50 familje që jetojnë me asistencë sociale në territorin e komunës, në prag të festës së Kurban Bajramit.

Kryetari Ahmeti nënshkruan kontratat për subvencionimin e qumështit me fermerët



Kryetari i Komunës së Lipjanit, z. Imri Ahmeti, ka pritur në takim fermerët e komunës, me të cilët janë nënshkruar kontratat për subvencionimin e çdo litri të qumështit të prodhuar.

Me këtë rast, kryetari Ahmeti theksoi se kjo është një mbështetje e drejtpërdrejtë për punën, përkushtimin dhe qëndrueshmërinë e tyre të përditshme.

“Ky është viti i dytë radhazi që mbështesim blegtorët përmes subvencioneve për çdo litër qumështi dhe tashmë është i dukshëm një trend pozitiv, është rritur si numri i fermerëve që angazhohen në këtë sektor, ashtu edhe sasia e prodhimit të qumështit”, tha kryetari z. Imri Ahmeti.

Ai shtoi se përveç subvencioneve për qumështin, Komuna do të vazhdojë me buxhetimin dhe mbështetjen edhe për sektorë të tjerë të bujqësisë dhe blegtorisë, meqë zhvillimi rural konsiderohet një shtyllë kyçe për mirëqenien dhe ekonominë lokale.

Gjatë takimit, kryetari Ahmeti bashkëbisedoi me fermerët për sfidat që ata përballojnë çdo ditë dhe shprehu gatishmërinë për t'i mbështetur më tej me pajisje ndihmëse dhe mjete konkrete që lehtësojnë punën dhe rrisin efikasitetin në sektorin e blegtorisë. Komuna e Lipjanit mbetet e përkushtuar të vazhdojë me politika zhvillimore dhe mbështetje të qëndrueshme për fermerët dhe për bujqësinë në përgjithësi.



Kryetari Ahmeti nderon me homazhe dëshmorin Xhavit Kozhani dhe martirët në Ribar të Madh e Zllakuqan



Kryetari i Komunës së Lipjanit, z. Imri Ahmeti, së bashku me bashkëpunëtorët e tij, ka bërë homazhe dhe ka vendosur buqetë me lule pranë lapidarit të dëshmorit të kombit Xhavit Kozhani – Burgia, në Lipjan dhe në fshatin Ribar i Madh, në nderim të jetës dhe veprës së tij, me rastin e 26-vjetorit të rënies.

Në kuadër të homazheve, u bënë nderime edhe pranë varrezave të martirëve në Ribar të Madh dhe në Zllakuqan, për të kujtuar me mirënjohje të thellë ata që sakrifikuan jetën për lirinë e atdheut. Me këtë rast, kryetari Ahmeti theksoi se kujtimi për dëshmorët dhe martirët e kombit do të mbetet përherë i gjallë, duke shërbyer si frymëzim për brezat që vijnë dhe si obligim për të ndërtuar të ardhmen me dinjitet dhe përkushtim.

Lavdi të përjetshme të gjithë atyre që ranë për liri!

Në kuadër të aktiviteteve për nder të 1 Qershorit , Ditës Ndërkombëtare të Fëmijëve , një grup fëmijësh nga çerdhja e re në Rufc të Ri realizoi një vizitë në ambientet e Komunës së Lipjanit , ku u prit nga Kryetari, z. Imri Ahmeti.



Gjatë takimit, Kryetari Ahmeti bashkëbisedoi me mësueset dhe fëmijët, duke u uruar mirëseardhje dhe duke shprehur kënaqësinë për këtë vizitë të veçantë. Ai theksoi rëndësinë e investimeve në edukimin e hershëm dhe u shpreh i lumtur që me ndërtimin e çerdhes në Rufc të Ri , e cila aktualisht kujdeset për rreth 75 fëmijë, janë krijuar kushte të përshtatshme për zhvillimin dhe përgatitjen e tyre në kuadër të edukimit të hershëm, që luan një rol kyç në formimin e fëmijëve .

Kjo vizitë simbolike ishte një moment i veçantë për fëmijët, të cilët sollën me vete gëzimin dhe atmosferën festive të 1 Qershorit.

KPF mban mbledhjen e 37-të me radhë



Komiteti për Politikë dhe Financa (KPF), udhëhequr nga Kryesuesi i Kuvendit z. Daut Azemi, ka mbajtur mbledhjen e 37-të me radhë, ku janë diskutuar të gjitha pikat e rendit të ditës të propozuara për këtë mbledhje.



Me këtë rast, Kryesuesi i Kuvendit, z. Daut Azemi, përveç pikave të propozuara për këtë mbledhje, ka prezantuar edhe një pikë shtesë për diskutim në këtë mbledhje.

Anëtarët e KPF-së pas diskutimeve, kanë rekomanduar të gjitha pikat për shqyrtim dhe aprovim në mbledhjen e ardhshme të Kuvendit të Komunës, e cila do të mbahet të enjten, më 29 maj 2025.

U mbajt mbledhja e 42-të me radhë e Kuvendit të Komunës së Lipjanit



Kuvendi i Komunës së Lipjanit, i udhëhequr nga Kryesuesi, z. Daut Azemi, zhvilloi punimet e mbledhjes së 42-të me radhë, ku u shqyrtuan dhe u miratuan pikat e rendit të ditës, të cilat ishin propozuar për këtë seancë.

Kryetari i Komunës së Lipjanit, z. Imri Ahmeti, gjatë kësaj seance ka dhënë sqarime për të gjitha pyetjet dhe çështjet e ngritura nga anëtarët e Kuvendit të Komunës.

Gjatë punimeve të kësaj seance u miratuan këto pika të rendit të ditës:

Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 41-të e Kuvendit.

Propozim Vendim për miratimin e Strategjisë për zhvillimin dhe fuqizimin e rinisë në Komunën e Lipjanit (2025-2030) dhe Planit të Veprimit Rinor Lokal (2025-2027).

Propozim Vendim për caktimin e lokacionit për varreza në fshatin Qylagë.

Propozim Vendim për miratimin e ofertës së përzgjedhur nga Komisioni Vlerësues për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës, ZK – Grackë e Vjetër.

Propozim Vendim për ndarjen e mjeteve financiare për subvencionimin e aktiviteteve të kryetarëve të këshillave të fshatrave dhe lagjeve urbane të Komunës së Lipjanit.

Propozim Vendim për ndarjen e mjeteve financiare për Islamik Relief Worldwide – zyra në Kosovë (IRW).

Propozim Vendim për furnizimin e përkohshëm me derivate të automjeteve të njësisë operative “KRM Pastrimi” në Lipjan.

Propozim Vendim për plotësimin dhe ndryshimin e vendimit 1nr.464-47684, të datës 29.09.2015, për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronave të paluajtshme të Komunës.



Komuna e Lipjanit – Zyra për informim



<https://lipjan.rks-gov.net/>



infokomuna.lipjan@rks-gov.net



0 800 14 000 / 038 200 41 508